



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**A nr. 292/2010**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muharrem Shala kryesues, Ymer Hoxha dhe Muhamet Rexha, anëtarë, duke vendosur përkritazi për ankesën e Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës dega në Rahovec, për shkak të kërcënimit dhe shantazheve në forma të ndryshme nga militantet e subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe të subjekti politik Lëvizja për Integrim dhe Bashkim (LIB), në seancën e panelit të mbajtur me 24.11.2010, mori këtë:

### V E N D I M

Hidhet poshtë ankesa si e pasafatshme

### A R S Y E T I M I

Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës dega në Rahovec, ka parashtruar një ankesë më të cilën pretendon se në Qendrën e Votimit (QV) nr.1612a, ka pas vërejtje nga menaxheri i Qendrës së Votimit për prezencën e punëtorëve e të militantëve të LIB-së dhe AAK-së në korridor dhe në hyrje të QV-së të cilët kanë shantazhuar dhe kërcënuar votuesit në forma të ndryshme që të votojnë për kandidatin e AAK-së.

### F A K T E T

Më 23 Nëntor 2010, në ora 18:00, Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) ka pranuar një ankesë nga Subjektit politik PDK dega në Rahovec, me pretendim se militantët e LIB-së dhe AAK-së, kanë shantazhuar dhe kërcënuar votuesit në forma të ndryshme që të votojnë për kandidatin e AAK-së. Sipas parashtruesit të ankesës në QV 1612a, ka pas manipulim të votave duke u bazuar në shifrën e votave të kandidatit të AAK-së në 1000 vota.

## ANALIZË

Juridiksioni i PZAP'it lidhur me ankesat është caktuar në pajtim me kompetencat e dhëna nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në *Ligjin mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës – LZP*, Ligji Nr.03/L – 256 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L- 073 dhe *Ligjin për Zgjedhjet Lokale në Republikën Kosovës Ligji Nr. 03/L- 072*.

Neni 119 paragrafi 1 i LZP-së:

*Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-it, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket procesit zgjedhor të rregulluar sipas këtij ligji ose rregullave zgjedhore, mund të paraqes një ankesë pranë PZAP-it brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit, dhe PZAP-i do të vendos për ankesën brenda shtatëdhjetedy (72) orëve nga koha kur është parashtruar ankesa.*

Sipas dispozitës së lartcekur PZAP-i konstaton se ankesa është e pasafatshme, sepse ankesa në PZAP është pranuar pas shtatëdhjetenjë (71) orëve, të mbylljes së Qendrës së Votimit ndërsa afati për parashtrim të ankesës në PZAP, në këtë fazë të procedurës ka qenë njëzetekatër (24) orë.

Për këto arsye, bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
A nr. 292/2010 më datën 24.11.2010.

